



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 31, datë 23.10.2025

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "NALT HOTEL",
STRUKTURË HOTELERI DHE SHËRBIME ME 9 DHE 10 KATE MBI TOKË DHE 1
KAT NËNTOKË", ME VENDNDODHJE NË BASHKINË SHKODËR

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit", i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë "DBH Construction" sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: "Nalt Hotel", Strukturë hoteleri dhe shërbime me 9 dhe 10 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë", me vendndodhje në Bashkinë Shkodër, me subjekt zhvillues shoqërinë "DBH Construction" sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuesit vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Shkodër.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
BLENDI GONXHJA



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT



ADELAUDA ROKA

Nënshkruar më datë 26/05 / 2026